

MINISTRIA E BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL

Nr. 9160/1 Prot.

Datë 8.9 .2018

MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

Nr. 17497/11 Prot.

Datë 4.10 .2018

UDHËZIM

Nr. 14 , Datë 11.9 .2018

PËR

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 19. 2. 2018, "PËR
KRITERET, PROCEDURAT DHE MËNYRËN E ADMINISTRIMIT TË FONDIT TË
PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 6, pika 3, të ligjit nr. 9817, datë 22. 10. 2007, "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural", i ndryshuar, " të nenit 18, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të VKM nr. 701, datë 12. 10. 2016 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të peshkimit për periudhën 2016-2021", ligjit nr. 109, datë 30. 12. 2017 "Për buxhetin e vitit 2018"; të pikës 4, të VKM nr. 72, datë 7.2 2018, "Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2018", të VKM nr. 21, datë 12. 1. 2018, "Për disa shtesa në vendimin 709, datë 29. 10. 2014 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020", VKM nr. 22, datë 12. 1. 2018 "Për miratimin e kriterëve për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit", të Udhëzimit të Ministrisë së Financave, nr. 19, datë 3. 11. 2014 "Për zbatimin e regjimit të veçantë të masës së kompensimit të prodhimeve bujqësore, për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar",

UDHËZIJMË:

Në Udhëzimin nr. 1, datë 19. 2. 2018, "Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural", të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Në kreun I, masa nr. 15, në fjalinë e parë hiqen fjalët "sipas specifikimeve të masës 12".
2. Në kreun I dhe VI, masa nr. 30, pas fjalëve "Për krerë të lindur" shtohen fjalët "dhe tufën bazë".
3. Në kreun V, paragrafi i fundit, zëvendësohet me formulimin "Nëse ndonjë dokument nuk arrihet të gjenerohet nga regjistrat zyrtarë, aplikuesit informohen zyrtarisht për plotësimin dhe dorëzimin e tyre zyrtar në AZHBR".
4. Në kreun VI, pika 1, shkronja "f":

-Paragrafi “- Çertifikatë pronësie, e shoqëruar me hartën treguese dhe kartelën e pasurisë së paluajtshme, kjo e fundit e rifreskuar jo më herët se 3 muaj para aplikimit (për zonat ku ka përfunduar regjistrimi fillestar i tokës)”, zëvendësohet me formulimin “- Çertifikatë pronësie, e shoqëruar me hartën treguese dhe kartelën e pasurisë së paluajtshme”.

-Paragrafi “Kur aplikuesi mer tokë me qira:

- Kontratë qiraje me akt noterial, me individë ose subjekte, që e kanë tokën bujqësore në pronësi. Afati i qiradhënies të jetë jo më pak se pesë vjet, në rastin e kulturave drufrutorë dhe jo më pak se një vit për kulturat një vjeçare;
- Kontrata e qirasë për pasuritë e paluajtshme me natyrë bujqësore për një periudhë mbi nëntë vjet, akti noterial regjistrohet në regjistrin publik të ZVRPP. Në këtë rast duhet të paraqitet kartela e pasurisë ku është pasqyruar kontrata e qirasë”, zëvendësohet me formulimin:

“Kur aplikuesi merr tokë me qira:

- Kontratë qiraje me akt noterial ose një dokument të ligjshëm të nënshkruar mes paleve në prani të noterit, me individë ose subjekte, që e kanë tokën bujqësore në pronësi. Afati i qiradhënies të jetë jo më pak se pesë vjet, në rastin e kulturave drufrutorë dhe jo më pak se një vit, për kulturat një vjeçare”.

5. Në kreun VI, pika 2, nënndarja “i”, në shkronjën “e”, fjalët “vitin e aplikimit” zëvendësohen me fjalët “vitin para realizimit të mbjelljeve”.
6. Në kreun VI, pika 2, masat 1-11, nënndarja “i”, shkronja “f”, zëvendësohet me formulimin “Të realizojnë mbjelljet brenda 6 mujorit të parë të vitit 2018, me përjashtim të mbjelljeve të luleshtrydhes në serra dhe/ose tunele, që realizohen në periudhën gusht-tetor”.
7. Në kreun VI, pika 2, masa 37, nënndarja “i”, shkronja “e”, fjalët “data 15.11.2018”, zëvendësohen me fjalët “data 15.12.2018”.
8. Në kreun VI, pika 2, masat 13-19, 25 dhe 28, nënndarjet “iii”, shkronjat “d” dhe masat 26, 27, 31 dhe 37, nënndarjet “iii”, shkronjat “c”, përmbajtja e fjalive përkatëse zëvendësohet me formulimin: “Faturat e thjeshta tatimore (Formati A₄), duhet të jenë të shoqëruara me kuponin e kasës fiskale ose me mandat pagesë me vulën e subjektit”.
9. Në kreun VII, pas pikës 8/1, shtohet pika 8/2 me këtë përmbajtje:
“Për të gjithë aplikuesit e përfshirë në listat paraprake të fituesve, që nuk kanë dorëzuar pjesërisht ose plotësisht dokumentacionin përkatës brenda afatit të përcaktuar në pikën 8 dhe 8/1, AZHBR njofton publikisht në faqen e vetë zyrtare www.azhbr.gov.al dhe pranë zyrave përkatëse të aplikimeve, për dorëzimin e dokumentacionit brenda 15 ditë pune nga data e publikimit të këtij njoftimi.
Në listën e publikuar nga AZHBR nuk përfshihen aplikimet e skualifikuara, me përjashtim të aplikimeve të skualifikuara për masën 15 dhe 30, të cilat i nënshtrohen rivlerësimit”.
10. Në kreun IX, pika 2, masat 20-24 dhe 32-36, nënndarja “i”, në fund të shkronjës “e” dhe në nënndarjen “iii”, në fund të shkronjës “n”, shtohet fjalia “Kur aplikimi bëhet vetëm për linja, makineri e pajisje, qiraja të jetë jo më pak se 5 vjet nga momenti aplikimit”. Aplikimet e skualifikuara për këtë kriter i nënshtrohen rivlerësimit.

11. Në kreun IX, pika 2, masat 20-24 dhe 32-36, nënndarja "i", pas shkronjës "d", shtohet shkronja "d/1", me formulimin "Aplikuesi duhet të ketë lejen e ndërtimit të miratuar ose kërkesën për leje ndërtimi ose deklaratën paraprake për kryerjen e punimeve. Lidhja e kontratës do të bëhet vetëm për subjektet me leje ndërtimi ose me deklaratë paraprake për kryerjen e punimeve, të miratuar".
12. Në kreun IX, pika 2, masat 44, 46 dhe 52, nënndarja "i", në shkronjën "i", fjalia e dytë zëvendësohet me formulimin "Leja e ndërtimit ose deklarata paraprake për kryerjen e punimeve e miratuar sigurohet para lidhjes së kontratës"
13. Në kreun IX, pika 2, masa 45, nënndarja "i", në shkronjën "h", në fund të fjalisë shtohet formulimi "Leja e ndërtimit ose deklarata paraprake për kryerjen e punimeve e miratuar sigurohet para lidhjes së kontratës".
14. Në kreun IX, pika 2, masa 51, nënndarja "i", në shkronjën "i", në fund të fjalisë shtohet formulimi "Leja e ndërtimit ose deklarata paraprake për kryerjen e punimeve e miratuar sigurohet para lidhjes së kontratës".
15. Në kreun XI, pas pikës 11, shtohet pika 11/1, me këtë përmbajtje:
 "Përfituesve të financimit nga masat e mbështetjes nr. 12; 20-24; 32-36; 40; 44-52, mbas lidhjes së kontratës, u paguhet paraprakisht 30% e masës së financimit të kontraktuar, kundrejt garancisë së parapagesës, të lëshuar nga shoqëri sigurimi dhe/ose banka. Pagesa për situacione pjesore të punimeve të kryera dhe/ose blerje të makinerive dhe pajisjeve, bëhet deri në masën 80% të totalit të vlerës së investimit të lejuar, të vërtetuara kundrejt dokumentacionit dhe faturave përkatëse, duke zbritur vlerën e parapagimit. Pagesa ekzekutohet pasi bëhet verifikimi në vend, sipas procedurave të përcaktuara në pikën 7 dhe në paragrafin e parë të pikës 8, të kreut X".

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL**

NIKO PELESHI

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSMINISTRI

ILIR HALILAJ



**MINISTRI I FINANCËVE DHE
EKONOMISË**

ARRE AHMETAJ

